



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-102933/21 dt. 04.06.2021, të kërkuarit Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për rindertimin/mbindërtimin e pjesës së ndërtesës ekzistuese me etazhitet P+0 në etazhitet të planifikuar P+1+Nk, në shfrytëzim të Gjykatës Kushtetuese, ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues “Qyteza Pejton” dhe PZHU-së, në rr. “Perandori Justinian”, nr. 44 dhe 46, Lagjja “Pejton”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 28.07.2021, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuarit, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me seli nga Prishtina, rr. “Perandori Justinian”, nr. 44 dhe 46, Lagjja “Pejton”, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-102933/21 dt. 04.06.2021, përdorimi i ndërtesës së rindërtuar/mbindërtuar si pjesë e ndërtesës ekzistuese me etazhitet P+0 në etazhitet të planifikuar P+1+Nk, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351/02 – 142213/19 dt.19.06.2019, në parcelën kadastrale nr. 7142-0, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër në kuadër të Planit Rregullues “Qyteza Pejton” dhe PZHU-së në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Perandori Justinian” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 44 dhe 46 në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuarisi, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me seli në Prishtina, rr. “Perandori Justinian”, nr. 44 dhe 46, Lagjja “Pejton”, me kërkesën 05 Nr. 391/02-102933/21 dt. 04.06.2021, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën, e rindërtuar/mbindërtuar si pjesë e ndërtesës ekzistuese me etazhitet P+0 në etazhitet të planifikuar P+1+Nk, ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues “Qyteza Pejton” dhe PZHU-së në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. nr. 7142-0, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351/02 – 142213/19 dt.19.06.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-88397/21 dt. 01.06.2021, ka përcjellë në

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 6 të e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Nexhat Berisha; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Mexhid Zylfiu/Zenun Tolaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Astrit Salihu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Shpresa Osmanaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Musa Lufaj; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Naser Berisha; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Afrim Kukaj me nr. të licensës 01;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

I dorëzohet: Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-102933/21 DT. 28.07.2021



Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu

B. Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi

Drejtori,
Gardian Olluri



